

QYTETARËT, SUPERHERONJË



TË KOSOVËS

DEMOKRACIA IME

ABAZ (15), LEON (14), RINA (14), ALBION (14), BENJAMIN (14), TRINGA (14), ELMEDINA (14),
FATBARDHA (14), BLENDA (14), VALBONA (14)



Jemi duke iu shkruar drejtpërdrejt nga Punëtorja e Demokracisë „Demos-ti“

Në lagjen time jeton një grua e moshuar. Ajo është shumë e këndshme, e buzëqeshur dhe e dashur me të gjithë. Andaj, ne të gjithë e duam dhe e respektojmë



atë. Ajo bën pjesë në komunitetin ashkali. Komunitet ky jo shumicë në Kosovë. Mirëpo, kjo asnjëherë nuk na ka penguar që ne të shoqërohemi së bashku. Ajo pothuajse çdo ditë vjen në vizitë tek familja ime, por edhe tek fqinjët e tjerë. Ne gjithashtu e vizitojmë atë. Nuk hezitojmë kurrë t'i ndihmojmë asaj në blerjen e ushqimit dhe me gjithçka tjetër që i nevojitet. Ky është humaniteti në një vend demokratik. Aty ku mbizotëron barazia, harmonia, paqja, toleranca dhe solidariteti në mes qytetarëve. Këto janë edhe elementet e saj. Demokracia nuk bën dallime, ajo paraqet dashurinë

dhe përkushtimin ndaj njëri-tjetrit, por edhe ndaj shtetit tonë. Demokracia nuk e përjashton askënd nga përqafimi i saj. Andaj, edhe ne të gjithë duhet ta mos e përjashtojmë njëri-tjetrin. Në demokraci duhet bërë çfarë është e drejtë. Por, ju mos harroni se cilat janë të drejtat që ne i gëzojmë në demokraci. Ne po i numërojmë disa: e drejta e votës, e shprehjes së lirë, e punës, e arsimimit, e familjes, e strehimit, e argëtimit, etj. Me anë të këtij artikulli, duam të ngrisim vetëdijen e të gjithë juve, lexues të dashur. Duam që edhe ju të kuptoni që demokracia është kudo me ne. Ne jetojmë në bazë të elementeve të saj. Që nga viti 507 p.e.s. kur demokracia lindi për herë të parë, njerëzimi ka kuptuar vlerat e vërteta të jetës. Këto vlera nuk duhet t'i humbasim asnjëherë. Të gjithë duhet të punojmë bashkë për të rritur dhe ngritur demokracinë tonë.



Autorët e demokracisë



Barazia gjinore në demokraci na bën shumë të lumtur. Mirëpo, ne gëzojmë edhe shumë të drejta të tjera



Të gjithë në grupin tonë kemi dhënë kontribut në shkrimin e këtyre artikujve

Të gjithë ne luajmë një rol shumë të rëndësishëm në ndërtimin e demokracisë. Cilat janë disa nga gjërat që ne mund t'i bëjmë për demokracinë? Na lejoni t'iu tregojmë çfarë mund të bëjmë ne si qytetarë

Demokracia bën kaq shumë për neve. Por, çfarë mund të bëjmë ne për të dhe për shtetin tonë? Shumë e thjeshtë. Demokracia është udhëheqje e popullit. Pra, ne si qytetarë e kemi timonin në duart tona. Andaj, është shumë e rëndësishme që ne të jemi të vëmendshëm, sepse të gjitha vendimet dhe veprimet tona ndikojnë në shtet. Përse të mos e shfrytëzojmë këtë pushtet që kemi në demokraci për të bërë diçka të mirë për vendin tonë? Si shembull, ne mund të bëhemi qytetarë më vizionarë dhe të shohim përtej interesave tona. Si nxënës mund të organizohemi dhe të mbjellim fidane në shkollën tonë. Kështu, nxënësit që vijnë pas nesh, do ta gëzojnë parkun në shkollën tonë. Ne njëkohësisht, ruajmë shëndetin tonë dhe atë të tjerëve duke mbjellur fidane. Ky gjest i vogël do të thotë shumë për shtetin.



Këtu po e shihni Abazin, i cili është duke punuar për këtë artikull. Ne, sikurse Abazi kemi pasur detyrat tona të ndara, në grup të vogël

KUVENDI ZGJEDH PRESIDENTIN DHE KRYEMINISTRIN

ALBION (14), ERZA (14), MIMOZA (14), BRIKENA (14), ELMEDINA (14), ENDRIT (14), DONARTA (14),

EDISON (14), ARLIND (14), ELIJESA (14)



Kuvendi është institucion, i cili zgjedhet në mënyrën më demokratike të mundshme. Si i tillë, në po këtë mënyrë, zgjedh me vota Presidentin dhe Qeverinë. Qeveria udhëhiqet nga Kryeministri

Demokracia është një term shumë i gjerë. Ajo nuk është vetëm liri e fjalës apo liri e votës. Demokracia është përditshmëria jonë, duke filluar kështu nga mëngjesi e deri në mbrëmje. Dita jonë si nxënës lidhet ngushtë me demokracinë. Atë e fillojmë në ambientin familjar, ashtu siç shpresojmë se e filloni edhe ju të dashur bashkëmoshatarë. Kjo është një nga të drejtat e shumta që ne kemi, e drejta e familjes. Pastaj, shkojmë në shkollë, në institucionin më të dashur për ne, e edhe kjo hyn në familjen e madhe të të drejtave tona. Përveç këtyre të drejtave, ne kemi edhe të drejtën e lojës, që do të thotë se ne kemi të drejtë për t'u argëtuar. Për të gjitha këto të drejta, përkujdeset shtëpia jonë e dytë, që është Kuvendi.

Kuvendi është institucion, roli i të cilit është shumë i madh në jetën tonë. Jo vetëm ne po mendojmë kështu, por, besojmë që edhe ju të dashur lexues e ndani të njëjtin mendim me ne. Falë këtij institucioni, ne qytetarët i gëzojmë të gjitha të drejtat që i kemi cekur më lart. Faktikisht, ne gëzojmë edhe shumë e shumë të mira të tjera përmes punës së Kuvendit. Kur jemi këtu, do të donim ta përmendim një nga tre funksionet kryesore që ka Kuvendi, që është miratimi i ligjeve. Ligjet na lehtësojnë dhe i japin ngjyrë jetës sonë, jetës së të gjithë qytetarëve. Kuvendi i trajton dhe i sheh të

gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë. Si ata qytetarë të cilët i përkasin komunitetit shumicë, po ashtu edhe ata qytetarë të cilët iu përkasin komuniteteve jo shumicë. Para ligjeve të miratuara nga Kuvendi jemi të gjithë të barabartë. Pasi që, veç jemi të funksionet, funksion tjetër është edhe përfaqësimi i popullit. Ky është një ndër funksionet më të dashura për qytetarët, sepse në një mënyrë apo në tjetrën i bën qytetarët të ndihen pjesë e vendimmarrjes. Funksion tjetër i Kuvendit është kontrolli që ia bën punës së Qeverisë. Këtë e bën në mënyrë që të kontrollojë nëse po i vë në funksion ky institucion të gjithë ligjet, që janë miratuar nga Kuvendi. Roli i Kuvendit nuk përfundon këtu, e për më shumë lexoni artikullin tjetër.




Artistët e rinjë



Me shumë kënaqësi, iu ftojmë që të informoheni më shumë rreth mënyrës se si Kuvendi dhe ligjet që dalin nga aty, ndikojnë jetët tona si qytetarë demokratikë


Nuk e dijmë me siguri, por ne mendojmë se ka qytetarë të cilët asnjëherë nuk e kanë menduar rëndësinë e Kuvendit në jetën e tyre. Ne jemi këtu për t'iu treguar për këtë gjë.

Kuvendi është institucioni më i rëndësishëm në jetën tonë. Thamë se këto ligje ndikojnë shumë tek të gjithë ne. Janë pikërisht deputetët, ata të cilët punojnë aty dhe miratojnë ligje. Ne shkojmë në shkollë, sepse ligji thotë kështu. Ligji, po ashtu, thotë se kur të arrijmë moshën 18 vjeçare ne mund të ndjekim edukimin universitar. Kështu pra, me anë të këtij shembulli, ne menduam se ju do ta kuptoni rëndësinë e Kuvendit.



E drejta e familjes në demokraci

Të gjithë duhet të jemi të bashkuar që të jetojmë të lumtur



Vetëm kështu arrijmë të ndërtojmë një botë më të mirë


Të qenurit gazetarë na ka mbushur me përgjegjësi, por edhe me vetëbesim



Puna në grup është shumë e rëndësishme



Në klasën tonë ka talente të shumta. Këtu jemi duke shpalosur disa nga aftësitë tonat në aktrim dhe në muzikë



Votat tona luajnë rol të rëndësishëm në shtetin tonë dhe të ardhmen e tij. Prandaj, duhet të jemi shumë të kujdesshëm kujt ia besojmë votën



Ta trajtojmë njëri-tjetrin me respekt dhe të jemi tolerant. Vetëm kështu, mund ta ngrisim demokracinë


PROCESI ZGJEDHOR NË KOSOVË

ILIR (14), ERLIND (14), SHKURTE Z. (14), SHKURTA R. (15), MILOT (14), VLERA (14), SHPRESA (15), SHQIPE (14), ALTIN (14), SHYHRETE (14)



Ne jemi disa gazetarë nga Punëtorja e Demokracisë. Sot kemi vendosur të flasim për procesin zgjedhor në Kosovë. Ne mendojmë se ky proces është shumë i rëndësishëm për demokracinë e Kosovës

Artikullin do ta fillojmë duke iu folur për partitë politike. Ndoshta ju dëshironi të dini se çfarë janë ato. Partitë politike, sipas diskutimit tonë, janë një grup i qytetarëve, të cilët kanë ide dhe vizion të përbashkët për të ardhmen e Kosovës. Qytetarët e Kosovës janë



të ndryshëm dhe kanë mendime të ndryshme. Prandaj, edhe partitë politike të Kosovës janë të ndryshme. Disa parti fokusohen në zhvillimin ekonomik, disa parti politike fokusohen në gjelbërimin e shtetit, kurse disa të tjera fokusohen në zhvillimin e arsimit dhe të shëndetësisë. Por, për t'i votuar ato dhe kandidatët e tyre duhet të arrijmë moshën 18 vjeçare.

Si në çdo shtet tjetër demokratik, edhe në Kosovë filloi

organizimi i zgjedhjeve. Këtë vit, ndryshe nga vitet e tjera, edhe unë kisha mundësinë të votoj, sepse mbusha 18 vjet. Kjo ishte shumë e rëndësishme për mua, ngaqë ishte hera e parë. Prandaj, vendosa që si një qytetare e Kosovës të përshkruaj procesin zgjedhor që ngjan në Kosovë.

Erdhi dita e votimit, u zgjova në mëngjes dhe kuptova që ishte ditë e veçantë, sepse do të zgjedh dikë, i cili është i gatshëm të përmbush kushtet në mënyrë që të udhëheq vendin tim. U nisa për tek vendvotimi. Kur mbërriva aty, pashë shumë njerëz të cilët na orientonin. Kaluam nëpër disa faza të votimit, e ato ishin: kontrollimi i gishtërinjëve për ngjyrë, dhënia e letërnjoftimit dhe nënshkrimi, si dhe marrja e letrave të votimit. Në fund, në mënyrë individuale, shkuam në kabina dhe vendosëm një shenjë dalluese te partia dhe kandidati i preferuar. Votimi për ne është shumë i rëndësishëm, sepse ne jemi ata të cilët vendosim se kush do ta udhëheq vendin tonë për vite me radhë.



Shkrimtarët e këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Hilmi Rakovica“
Klasa: IX-3
Vendi: Prishtinë